



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“ZYRA E PËRMBARIMIT BEST 2010”

Nr.66/7 prot

Data 11 dhjetor 2020

URDHER

Lënda: Sekuestro për asetet e debitorit

Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Biznesit

I nderuar drejtues,

Unë Saimir Hoxha, Përmbaruesi Gjyqësor, pasi studiova dokumentacionin që i përket Urdhrit të Ekzekutimit nr. 479, datë 24.09.2020 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës,

KONSTATOVA:

Se pranë kësaj zyre përmbarimi është depozituar kërkesa e kreditorit për zbatimin e titullit ekzekutiv me palë e objekt:

-Kreditor: “SELLER-GROUP” shpk

-Debitor: Shoqëria “GIA 2019 “shpk NUIS L82421015D Administrator Lorenc Ndreu

-Objekti: Detyrim monetar

Nga shqyrtimi i dokumentacionit del se debitori duhet të përmbushë detyrimin ndaj kreditorit si dhe shlyerjen e tarifave/shpenzimeve përmbarimore gjyqësore.

Debitori duhet të shlyejë detyrimin e përcaktuar në titullin ekzekutiv.

Ende debitori nuk e ka shlyer këtë detyrim e për rrjedhojë QKB mund të nxjerrë një njoftim/shpallje ku të evidentohet ky detyrim, etj.

Për sa më sipër bazuar në nenet 519 e në vijim të K.Pr.C e ligjit nr.26, dt.08.05.2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor” i ndryshuar,

JU KËRKOJ QË:

- 1- Të mbani nën sekuestro asetet që i takojnë debitorit në çdo lloj aktiviteti për të cilin ju keni informacion;
 - 2- Të informoni me shpallje ose me punonjësit tuaj, debitorin për këtë detyrim;
 - 3- Të më informoni për veprimet tuaja rreth kësaj kërkesë brenda afateve ligjore.
- Bashkëlidhur ju lutem gjeni një kopje të urdhrut ekzekutiv.

**PËRMBARUESI GJYQËSOR
SAIMIR T. HOXHA**

